

MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË MASAVE ANTI COVID-19 NGA SHKOLLAT NË KOSOVË

Raporti i monitorimit për periudhën 23 tetor - 15 nëntor 2020

edutask

BIRN
BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK
KOSOVO

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo



MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË MASAVE ANTI COVID-19 NGA SHKOLLAT NË KOSOVË

Raporti i monitorimit për periudhën
23 tetor - 15 nëntor 2020

Monitorimi i përmbushjes së masave anti COVID-19 nga shkollat në Kosovë

Raporti i monitorimit për periudhën 23 tetor - 15 nëntor 2020

Të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të masave anti Covid-19 nga shkollat në Kosovë gjatë muajit Nëntor, përkatësisht prej datës 23 tetor deri me datën 15 nëntor, të paraqitura në figurën 1, tregojnë qartazi se nga 4 masat e vendosura nga MASH, masa 'Taskforca në nivel institucioni parashkollor apo shkolle' mbetet masa e zbatuar më së shumti në nivel vendi e përmbushur 89.3%, e përcjellur nga 'Masat parandaluese: testimi, raportimi i rasteve me Covid-19 dhe ndërprerja e mësimit' me 83.28%, 'Masat parandaluese higjienike dhe mbrojtëse - Përgatitja e shkollës për fillimin e vitit shkollor' me 80.88%, dhe masa e zbatuar më së paku në nivel vendi mbetet 'Organizimi i procesit mësimor sipas tre skenarëve të paraqitur në udhëzuesin e MASH' e përmbushur vetëm 66.13%.




Figura 1. Përmbushja e masave anti Covi-19 nga shkollat në nivel vendi

Nga katër masat, në nënmasat e zbatuara më shumë se 95% në nivel vendi radhiten:

- **Është siguruar pjesëmarrja aktive e mësimdhënësve (97.5%)**
- **Mësimdhënësit janë plotësisht të informuar dhe pjesëmarrës aktivë (97.5%)**
- **Task forca është funksionale (96.5%)**
- **Shkolla ka hartuar orarin e mësimit në shkollë (96.5%)**
- **Janë ofruar udhëzimet e sakta dhe orari për mësimdhënësit për mësim sipas skenarëve (96%)**
- **Shkolla ka siguruar paisjen/t për matjen e përditshme të temperatures (96%)**
- **Është bërë dezinfektimi dhe pastrimi gjeneral i shkollës (95%)** dhe
- **DKA/ shkolla ka siguruar ujë të rrjedhshëm gjatë orarit të punës (95%)**

Masat e përmbushura më shumë se 95%




Figura 2. Nënmasat e përmbushura më shumë se 95% në nivel vendi

Në anën tjetër, nënmasat e përmbushura më pak se 50% përfshijnë:

- **DKA dhe shkolla kanë siguruar transport të sigurt për grupe të caktuara të nxënësve(25%)**
- **Është mbajtur trajnimi për nxënësit për përdorimin e platformës (27%)**
- **DKA / Shkolla ka siguruar personel plotësues teknik për m2 (28.5%)**
- **Janë siguruar pajisjet teknologjike për nxënës (32.5%)**
- **Janë siguruar pajisjet teknologjike për mësimdhënës (38%)**
- **Është mbajtur trajnimi për mësimdhënësit për përdorimin e platformës (44.5%)**
- **DKA dhe shkolla kanë hartuar/miratuar listën për zëvendësim të përkohshëm të stafit të shkollës (45%) dhe**
- **DKA dhe shkolla kanë siguruar shërbime konsulence psikologjike (46%)**

Masat e përmbushura më pak se 50%




Figura 3. Nënmasat e përmbushura më pak se 50% në nivel vendi

Analiza në nivel të komunave e paraqitur në figurën 4 tregon se komunat me performancën më të mirë janë komuna e Junikut (94%), Kamenicës (90%), Kaçanikut (89%), Shtimes (88%), Skënderajit (88%), Ferizajit (88%), Gllogovcit (86%), Istogut (85%), Prishtinës (85%), ndërsa ndër komunat me performancë më të dobët radhiten komuna e Obiliqit (54%), Shtërpcës (55%), Podujevës (59%), Mitrovicës (64%), Mamushës (66%), dhe Suharekës (69%).




Figura 4. Përmbushja e përgjithshme e masave sipas komunave

Ndërsa një analizë që zbërthen zbatimin e masave për komunë e paraqitur në figurën 5 tregon se komunat Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gllogovc, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Viti, Vushtrri nga katër masat kanë zbatuar më së shumti masën 'Taskforca në nivel institucioni parashkollor apo shkolle', komunat Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Kamenicë, Klinë, Mitrovicë, Pejë, Shtime, dhe Skënderaj kanë zbatuar më së shumti 'Masat parandaluese: testimi, raportimi i rasteve me Covid-19 dhe ndërprerja e mësimit', ndërsa komuna e Gjilanit nga katër masat më së shumti ka zbatuar 'Masat parandaluese higjienike dhe mbrojtëse - Përgatitja e shkollës për fillimin e vitit shkollor'. Masa më së paku e zbatuar nga të gjitha komunat mbetet 'Organizimi i procesit mësimor sipas tre skenarëve të paraqitur në udhëzuesin e MASH', mirëpo në nivel komunash në përmbushjen e kësaj mase më së miri ka performuar komuna e Kamenicës, ndërsa komuna me performancën më të dobët në zbatimin e kësaj mase është komuna e Shtërpcës.




Figura 5. Zbatimi i masave anti Covid-19 nga shkollat sipas masës dhe komunës

Figura 6 paraqet skenarin e përdorur nga shkollat e monitoruara për komunë gjatë kohës së monitorimit, nga ku mund të vërejmë se gjatë kohës së monitorimit shkolla që kanë kaluar në skenarin C janë regjistruar në komunën e Obiliqit, Vushtrrisë, Fushë Kosovës, dhe Prishtinës, ndërsa shkolla që kanë adaptuar skenarin B janë regjistruar në Gjilan, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Vushtrri, dhe Pejë. Marrë parasysh numrin e kufizuar të mostrës dhe ndryshimet e shpejta në skenaret me të cilët punojnë shkollat për shkak të rritjes së rasteve të infektimit me Covid-19, këto të dhëna mund të mos përputhen plotësisht me situatën aktuale. Poashtu duke pasur parasysh që shkollat ndërrojnë skenaret sipas situates epidemiologjike, ky raport paraqet vetëm raportimin brenda dy javëve kur është bërë monitorimi.




Figura 6. Skenarët e zgjedhura nga shkollat sipas komunave



MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË MASAVE ANTI COVID-19 NGA SHKOLLAT NË KOSOVË

Raporti i monitorimit për periudhën 23 tetor - 15 nëntor 2020

edutask

BIRN BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK KOSOVO

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG Büro Kosovo